OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES Sh.a.
("OSSH")

PASQYRAT FINANCIARE PER PERIUDHEN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2008

Tirane me -------2009

Table of Contents

1. TE PERGJITHSHME 8
2. PERMBLEDHJE TE POLITIKAVE KONTABEL 8
A. BAZAT E PERGATITJES 9
B. PERDORIM I GJYKIMEVE DHE VLERESIMEVE 9
C. RAPORTIMI I SEGMENTIT 9
D. KONVERTIMI I TRANSAKSIONEVE NE MONEDHE TE HUAJ 9
E. EMRI I MIRE, AKTIVET E PAPREKSHME , PRONA, MAKINERITE DHE PAJISJET 10
F. TESTI I RENIES NE VLERE PER AKTIVET JO-FINANCIARE 10
G. QIRATE OPERATIVE 11
H. INVENTARET DHE PRODHIMI NE PROCES 11
I. DETYRIMET PER PENSION, PERFUNDIMIN E PUNES, TE TJERA DETYRIME NDAJ PONONJESVE DHE DETYRIMET PER PERFITIMET PAS LARGIMIT NGA PUNA 11
J. PROVIZIONET 11
K. TATIMI I SHTYRE 11
L. TATIMI AKTUAL 12
M. TE ARDHURAT 12
N. INSTRUMENTAT FINANCIAR DHE C'RREGJISTRIMI I TYRE 13
O. SHPERNDARJA E DIVIDENTEVE 15
P. GRANTET QEVERITARE 15
Q. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET E MJETEVE MONETARE 15
3. MENAXHIMI I RISKUT 15
4. CMUARJET DHE GJYKIMET KRITIKE TE KONTABILISTETIT 24
5. INFORMACIONI SIPAS SEGMENTEVE TE BIZNESIT 27
6. TE ARDHURAT 28
7. TE ARDHURA TE TJERA 28
8. BLERJET E ENERGJISE 28
9. SHPENZIMET E PERSONELIT 29
10. SHERBIMET TE KRYERA NGA PALET E TRETA 29
11. TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE 29
11.1 BUROJNE NGA INTERESI 29

11.2 BUROJNE NGA KURSET E KEMBIMIT 29
12. SHPENZIME TATIM FITIMI 30
13. AKTIVET FIKSE 32
14. HUATE DHE PARADHENIET 33
15. INVENTARET DHE PRODHIMI NE PROCES 34
16. LLOGARITE E ARKETUESHME 34
17. AKTIVE TE TJERA FINANCIARE KORRENTE 35
18. HUAMARRJET AFATGJATE 36
19. HUAT AFATSHKURTERA NGA INSTITUCIONET FINANCIARE 37
20. GRANTET QEVERITARE 38
21. LLOGARITE E PAGUESHME 38
21.1 PERFITIMET E PUNONJESVE 38
21.2 DETYRIMET NDAJ SHTETIT PER TAKSAT 39
22. KAPITALI I PAGUAR DHE REZERVAT LIGJORE 39
23. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET E MJETEVE MONETARE 40
24. PALET E LIDHURA 41
25. SPIN-OFF 42
26. ANGAZHIMET 43
27. DETYRIMET JASHTE BILANCIT 43
28. NGJARJET PAS DATES SE BILANCIT 43
29. STANDARDE , NDRYSHIME DHE INTERPRETIME 43

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
PER PERIUDHEN USHTRIMORE 1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2008

		Periudha qe u mbyll me	
	Note	*31-dhjet-08*	*31-dhjet-07*
Te ardhurat nga shitja	6	33.331.062	25.893.408
Te ardhura te tjera	7	891.318	372.921
		34.222.380	**26.266.329**
Lende te para dhe te tjera materiale konsumi		-793.745	-902.900
Blerje energjie	8	-29.674.246	-16.457.394
Shpenzimet e Pagave dhe perfitimeve te punonjesve	9	-3.711.114	-3.364.626
Renia ne vlere e inventarit	15	-112.914	
Renia ne Vlere e Llogarive te Arketueshme	3,4,16	-2.939.199	-2.526.263
Renia ne vlere e Aktiveve Fikse	13	0	-10.685.143
Zhvlersimi, Amortizimi	13	-2.516.663	-2.311.596
Shpenzim te tjera	10	-1.205.801	-1.042.398
Fitimi (humbja) operative		**-40.953.682**	**-37.290.320**
Te ardhurat financiare	11	3.314	2.179
Shpenzimet Financiare	11	-1.122.161	-5
		-1.118.847	**2.174**
Humbja perpara tatim fitimit		**-7.850.149**	**-11.021.817**
Shpenzimet e tatim fitimit	12	-1.283.789	-1.845
Humbje per vitin		**-9.133.938**	**-11.023.662**

Pasqyrat Financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese ne vijim 1-29

BILANCI KONTABEL I DATES 31 DHJETOR 2008

	Note	Periudha qe u mbyll me 2008	2007
Aktivet			
Aktivet Fikse			
Ndertesa,makinerite dhe pajisjet	13	17.399.956	16.319.822
Huat dhe Paradheniet	14	28.255	28.596
		17.428.211	**16.348.418**
Aktivet Rrjedhese			
Inventaret	4,15	2.855.399	2.648.396
Llogarite e arketueshme dhe te tjera te arketueshme	3,4,16	10.672.074	6.753.070
Huate dhe Paradheniet			624
Aktive te tjera	17	2.917.135	
Mjete Monetare dhe Ekuivalentet e Mjeteve Monetare	23	844.095	238.753
		17.288.703	**9.640.843**
Totali I Aktiveve		**34.716.915**	**25.989.261**
Kapitali			
Kapitali Aksionar		30.099.102	16.337.582
Rezerva te tjera		2.916.011	2.741.969
Fitmi (humbja) e Pashperndare		-19.820.925	-11.023.662
Totali I Kapitalit	**18**	**13.194.188**	**8.055.889**
Detyrimet			
Detyrimet AfatGjate			
Hua nga Institucioneve Financiare	19	11.346.962	15.627.614
Grantet Qeveritare	21	0	490.763
		11.346.963	**16.118.377**
Detyrimet Afatshkurter			
Hua nga Institucioneve Financiare	20	1.141.665	
Llogarite e pagueshme dhe te tjera te pagueshme	22	7.748.466	1.813.150
Detyrimi Tatim Fitimi I Shtyre	12	1.285.634	1.845
		10.175.765	**1.814.995**
Totali i Detyrimeve		**21.522.727**	**17.933.372**
Totali i Kapitalit dhe Detyrimeve		**34.716.915**	**25.989.261**

Pasqyrat Financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese ne vijim 1-29

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE PER PERIUDHEN USHTRIMORE 1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2008

		Periudha qe u mbyll me	
	Note	*31-dhjet-08*	*31-dhjet-07*
Humbjet e periudhes,perpara tatim fitimit		-9.133.939	-11.023.662
Rregullime per:			
– zhvlersimi, amortizimi	13	2.504.939	2.311.596
– renia ne vlere e aktiveve afatgjata materiale	13	0	10.685.143
–renia ne vlere e inventarve dhe aktiveve te tjere te larguar	4,15	126.304	12.941
– humbjet nga renia ne vlere e llogarive te arketueshme	3,4,16	2.939.199	2.526.263
– te ardhura jo-monetare nga subvencionet dhe grantet	7	-510.075	-35.147
– te ardhurat nga interesi	11	-1.763	-2.179
– shpenzimet nga interesi	11	14.639	5
Ndryshimet ne Kapitalin punues:			
– inventaret	4,15	-333.308	-2.661.337
– llogarite e arketueshme dhe te tjera te arketueshme	3,4,16	-7.321.843	-8.815.792
– huate afatshkurter	20	1.141.665	0
- Llogarite e pagueshme dhe te tjera te pagueshme	22	5.935.316	1.813.150
- aktive dhe Detyrime te tjera	22	-2.453.951	-463.542
- detyirme te tjera - tatim I shtyre	12	1.283.790	1.845
		-5.808.569	**-5.650.716**
interes I paguar	11	-14.639	-5
Tatim fitimi I paguar			
MjeteMonetare neto gjeneruar nga Aktiviteti Operative		***-5.823.207***	***-5.650.721***
Flukste Monetare nga Aktiviteti Investues			
Blerja e ndertesave, makinerive dha pajisjeve	13	-5.025.610	-29.316.560
Shitje e ndertesave, makinerive dha pajisjeve	13	1.440.537	
Rritje/zvogelim Huave dhe Paradhenieve	14	965	-29.220
Interes I arketuar	11	1.763	2.179
Mjetet Monetare neto te perdorura ne aktivitetin investues		***-3.582.345***	***-29.343.601***
Flukste Monetare nga Aktiviteti Financues			
Rritje/zvogelim grantet qeveritare	7,21	19.312	525.910
Rritje/zvogelim Huate dhe Paradheniet nga bankat	19,20	-4.280.652	15.627.614
Rritje/zvogelim I rezervave	18	174.042	2.741.969
Rritje/zvogelim I Fitimit te pashperndare	18	336.673	
Rritje/zvogelim I Kapitalit Aksioner	18	13.761.520	16.337.582
Mjetet Monetare neto te gjeneruara nnga aktiviteti financues		***10.010.895***	***35.233.075***
Rritje/zvogelim neto ne Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e Mjeteve Monetare		**605.342**	**238.754**
Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e Mjeteve Monetare ne fillin te periudhes	23	238.753	
Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e Mjeteve Monetare ne fund te periudhes		**844.095**	**238.754**

Pasqyrat Financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese ne vijim 1-29

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TE KAPITALI AKASIONAR PER PERIUDHEN USHTRIMORE 1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2008

	Kapitali Aksionar	Kapital I nenshkruar i Papaguar	Pakesim kapitali i Parregjistr	Shkeputja e Aktiveve te HPP	Rezerva te tjera	Fitim (Humbje) Mbartur	TOTAL
Rritja e Kapitali Aksioner	22.745.663	2.000					22.747.663
Zbritje e Kapitalit Aksioner							0
Kontributi Kapital I Parregjistruar							0
Zbritje e Kapitalit Aksioner parregjistruar			-6.263.306				-6.263.306
Shkeputje e Aktiveve HPP				-146.775			-146.775
Rezerva te tjera					2.741.969		2.741.969
Humbjet e Mbartura						-11.023.662	-11.023.662
Teprica me 31 Dhjetor 2007	**22.745.663**	**2.000**	**-6.263.306**	**-146.775**	**2.741.969**	**-11.023.662**	**8.055.889**
Rritja e Kapitali Aksioner	7.877.310	6.388.646				336.675	14.602.631
Zbritje e Kapitalit Aksioner	-6.912.517	-2.000					-6.914.517
Kontributi Kapital I Parregjistruar							0
Zbritje e Kapitalit Aksioner parregjistruar			6.263.306				6.263.306
Shkeputje e Aktiveve HPP				146.775			146.775
Rezerva te tjera					174.042		174.042
Humbjet e Mbartura						-9.133.938	-9.133.938
Teprica me 31 Dhjetor 2008	**23.710.456**	**6.388.646**	**0**	**0**	**2.916.011**	**-19.820.925**	**13.194.188**

Pasqyrat Financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese ne vijim 1-29

Pasqyra Financiare te OSSH Sh.a. jane aprovuar nga Keshilli Mbikqyres me date ----------dhe firmosur nga;

Drejtori i Pergjithshem OSSH sh.a	Drejtoresha e Deges Ekonomike	Shefe e Kontabilitetit
Sahit Dollapi	Bukurie Cela	Aida Sefa

OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES OSSH 2007 OSSH sh.a.

1. Te pergjithshme

Operatori i Sistemit te Shperndarjes sh.a. (OSSH SH.A. ose OSSH) eshte themeluar si nje Shoqeri Aksionere me 19 Qershor 2007, bazuar ne vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 862 me date 20 Dhjetor 2006. OSSH u krijua si rezultat i shkeputjes nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. (KESH) dhe pergatiti pasqyrat financiare si nje njesi ekonomike e vecante per periudhen qe filloi me 1 Janari 2007. Shumica e aktiveve dhe e detyrimeve iu transferuan OSSH nepermjet shkeputjes gjate 2007 (referohu Shenimit 26). Qe nga 31 Dhjetori 2008 Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjise zoteron 100% te Kapitalit Aksioner per llogari te Qeverise se Shqiperise.

OSSH ka pergjigjesine per shperndarjen e energjise elektrie ne Shqiperi. OSSH aktualishte perbehet nga 5 njesi te tensionit te larte, 10 njesi shperndarjeje edhe aktivitetin e zyrave qendrore.

Ne 8 Prill 2008 Keshilli i Ministrave vendosi si me poshte:

- Te amendoj Vendimin Nr. 862 (referohu Shenimit 18.) duke i transferuar Kompanise nga KESH-i kontratat apo nen-kontratat e huamarrjes per fonde te perdoruara apo per tu perdorur per financimin e projekteve te investimit te Kompanise.
- Te transferoj zoterimin e Kompanise Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjise.
- Te transferoj zoterimin e pasurise se patundeshme nga KESH-i drejte OSSH.

Qe prej fundit te Dhjetorit 2008 Kapitali i Paguar i Kompanise eshte 22,665 Mije, nderkohe me 06.03.2009 eshte aprovuar nje shtese per rritjen e kapitalit per shumen 7,434,081.000 Lek (referohu Shenimit 22).

OSSH eshte e vendosur ne Shqiperi. Adresa e zyres se saj te regjistruar eshte Blloku Vasil Shanto, P.O. Box 259/1, Tirane, Shqiperi.

Keto Pasqyra Financiare jane aprovuar per botim nga Bordi i Mbikqyrjes me.....

Me 24 Prill 2009 Parlamenti i Shqiperise aprovoi Marrveshjen e Shitjes me Cez .a.s. nje kompani e themeluar ne Republiken Ceke, lider ne tregun e energjise ne Europen Qendrore dhe Jug-lindore.

Per me shume informacion ne lidhje me procesin e privatizimit referohu shenimit 29.

2. Permbledhje te Politikave Kontabel

Në datë 29.04.2004 u miratua Ligji Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe më pas u miratuan edhe Standartet Kontabël që lidhen me të. Ky ligj i ri përcaktoi zbatimin në Shqipëri të Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (të njohura si SNRF) për të gjitha shoqëritë tregëtare, pavarësisht nga madhësia dhe aktiviteti i tyre. Zbatimi i parë i tyre parashikohet në periudhën ushtrimore që përfundon më 31 Dhjetor 2008. Standartet Kontabël që do të zbatohen nga shoqëritë paraqiten si më poshtë:

(i) Bankat dhe Institucionet Financiare- të gjithë setin e SNRF dhe KNISRF përkatëse

(ii) Shoqëritë e Mëdha - të gjithë setin e SNRF dhe KNISRF përkatëse

(iii) Degët e shoqërive të huaja - të gjithë setin e SNRF dhe KNISRF përkatëse

(iv) Shoqëritë e Vogla dhe të Mesme – Standartet Kombëtare Kontabël të miratuara, të cilat përqëndrohen në zërat më kryesore të Pasqyrave Fianciare të shoqërive.

Ligji i ri i Kontabilitetit promovon zbatimin para afateve ligjore të standarteve nga shoqëritë e përmendura në pikën (i)- (iii).

OSSH zbatoi per here të pare SNRF per pergatitjen dhe prezantimin e Pasqyrave Financiare per 2007.

Ato përfshijnë standartet e aprovuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standarteve të Kontabilitetit (BNSK) dhe interpretimet e standarteve të botuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Standarteve të Raportimit Financiar (KNISRF) ose ish Komiteti i Përhershëm i Interpretimeve.

a. Bazat e Pergatitjes

Paqyrat Financiare te Operatori i Sistemit te Shperndarjes Sh.a. (ne vazhdim "Kompania"/ "OSSH") per periudhen qe mbyllet me 31 Dhjetor 2008, jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar ne fuqi ne daten e perpilimit. Per me teper informacion referohu Shenimit 29.

Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Lek Shqiptar dhe jane pregatitur mbi bazen e kostos historike pervec disa instrumenteve financiare.

- Instrumentet financiare derivative jane matur me vlere tregu
- Instrumentet financiare me vlere tregu nepermjet fitimit ose humbjes jane matur me vlere tregu
- Aktivet financiare te gatshme per t'u shitur jane matur me vlere tregu
- Investimet ne Aktive afatgjata materiale jane matur me me vlere tregu
- Detyrimet per shperblimet me aksione te vendosura per tu paguar ne para jane matur me vlere tregu

b. Perdorim i gjykimeve dhe vleresimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon perdorimin e gjykimeve, vleresimeve dhe supozimeve qe ndikojne shumen e mbartur te aktiveve dhe detyrimeve dhe informacionin e lidhur me zerat e perfshire dhe shenimet shpjeguese ne lidhje me zerat jashte bilancit. Gjykimet, vleresimet dhe supozimet jane bazuar ne eksperiencat e meparshme dhe faktore te tjere qe ne rrethana te caktuara konsiderohen te arsyeshem. Ato perdoren kur shuma e mbartur e aktiveve dhe detyrimeve nuk eshte lehtesisht e percaktueshme nga burimet e tjera. Per kete arsye rezultatet ekzistuese mund te pesojne ndryshime nga keto vleresime. Vleresimet jane perdorur per te njohur shumat per zhvleresimet per llogarite e dyshimta, zhvleresimin dhe amortizimin, humbjet nga renia ne vlere, detyrimet ne lidhje me perfitimet e punonjesve, tatimet dhe provizione te tjera. Vleresimet dhe supozimet korrigjohen here pas here dhe efektet e ndryshimeve nese ato i perkasin periudhes reflektohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Nese ekzistojne korrigjime te cilat perfshijne njekohosisht periudhen e tashme dhe ate te ardhme ndryshmi njihet ne periudhen ne te cilen eshte bere korrigjimi dhe ne periudhen e ardhme qe influencohet nga ky ndryshim.

c. Raportimi i Segmentit

Një segment biznesi është një grup aktivesh dhe veprimtarish të cilat bëjnë të mundur përftimin e mallrave ose shërbimeve që janë subjekt i rreziqeve dhe përfitimeve, dhe qe jane të ndryshme nga rreziqet dhe perfitimet e segmenteve të tjera të biznesit. Një segment gjeografik bën të mundur përftimin e mallrave ose të një shërbimi brenda një mjedisi të caktuar ekonomik të cilat janë subjekt i rrezikut dhe përftimeve të ndryshme nga ato të një segmenti tjetër i cili operon në mjedise të tjera ekonomike.

d. Konvertimi i transaksioneve ne monedhe te huaj

a) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ("monedha fuksionale"). Pasqyra financiare jane paraqitur ne Leke Shqipetar (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe e paraqitjes se Kompanise.

(b) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date.. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "të tjera të ardhura (shpenzime) financiare".

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2008 janë:

Date /Currency	31 Dhjet 2008	31 Dhjet 2007
Euro	123.8	121.78
USD	87.91	82.83

e. Emri i mire, Aktivet e Paprekshme , Prona, Makinerite dhe Pajisjet

Në përputhje me SNK 16 "Makineri & Pajisje" dhe SNK 38 "Aktivet Jomateriale", do të njihen si aktive vetëm ato elementë për të cilat kostoja mund të matet me besueshmëri dhe pritet të hyjnë përfitime ekonomike të ardhëshme ne OSSH sh.a. Në përputhje me SNK 36 "Rënia në vlerë e Aktiveve", sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në kushtet e tregut tregojnë një rrezik për rënien në vlerë të aktiveve jomateriale të makinerive dhe pajisjeve, duhet bërë një kontroll i detajuar me qëllim që të përcaktohet nëse vlera neto e mbartur e këtyre aktiveve është më e vogël se sa vlera e tyre e rekuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e madhe midis vlerës së drejtë (minus kostot e shitjes) dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim matet duke skontuar flukset e parashikuara të ardhshme të parasë nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivit dhe vlerës së tij përfundimtare në nxjerrjen e tij jashtë përdorimit (shitjes). Në rastin kur vlera e rekuperueshme është më e vogël sesa vlera neto e mbartur, diferenca midis këtyre dy vlerave do të regjistrohet si humbje nga rënia në vlerë. Humbjet nga rënia në vlerë për makineri dhe pajisje, ose aktivet jomateriale me jetë përdorimi të përcaktuar mund të anullohen nëse vlera e rekuperueshme tejkalon vlerën neto të mbartur (por nuk duhet të jetë më e madhe sesa humbja e regjistruar fillimisht).

i) Makinerite dhe Pajisjet

Pajisjet vlerësohen me kosto historike minus zhvlerësimin. Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përftimeve të ardhshme ekonomike në OSSH SH.A. dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbatjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Në OSSH SH.A., ndertesat, makineritë dhe pajisjet vlerësohen me kosto historike minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje nga rënia në vlerë. Shpenzimet e zhvlerësimit përgjithësisht llogariten gjatë jetës së përdorshme, si më poshtë:

- Ndertesa 25-30 vjet
- Makineri dhe Pajisje 35-40 vjet
- Mjete transporti 8-20 vjet
- Mobilje, orendi dhe pajisje 5 vjet

Shpenzimet e zhvlerësimit llogariten duke përdorur metodën lineare.

Aktivet e qëndrueshme (afatgjata) të blera nëpërmjet qirasë financiare ose marrëveshjeve afatgjata të qirasë të cilat të gjitha rreziqet dhe përfitimet lidhur me pronësisë e aktivit ia transferojnë thelbësisht OSSH (qiramarrës) kapitalizohen. Vlera e mbetur, nëse konsiderohet e rëndësishme, merret parasysh kur llogaritet zhvlerësimi. Makinerite & pajisje ndahen ne nëngrupe nëse ekziston një diferencë e rëndësishme në jetën e parashikuar të përdorimit të tyre, dhe zhvlerësimi llogariten për secilën më vete. Zhvlerësimi dhe humbjet nga rënia në vlerë regjistrohen si shpenzime dhe paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si kosto e produkteve te Shitura, kostove të kërkimit dhe zhvillimit ose shpenzimeve të administrimit dhe shitjes, në varësi të natyrës së aktivit.

f. Testi i renies ne vlere per aktivet jo-financiare

Shuma e mbartur e aktiveve jo-financiare te Kompanise , pervec inventareve dhe tatimit te shtyre jane rishikuar ne daten e raportimit te secilit per te percaktuar nese ka ndonje tregues per renie ne vlere. Nese ekzistojne tregues te tille atehere eshte vleresuar vlera e rikuperueshme e aktiveve. Nje humbje nga renia ne vlere eshte njohur nese

shuma e mbartur kontabilitet zvogelohet deri ne shumen e rikuperueshme. Humbjet nga renia ne vlere jane njohur ne Fitim/Humbje.

Shuma e rekuperueshem perfaqesohet nga shuma me e madhe midis vleres se drejte minus kostot e shitjes dhe vleres ne perdorim. Vlera ne perdorim eshte llogaritur si vlera e skontuar e flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te rregulluara nga faktoret e riskut qe mbartin.

Humbjet e renies ne vlere te njohura ne periudhat e meparshme jane vleresuar ne secilen date raportimi per ndonje tregues qe humbja eshte zvogeluar ose nuk ekziston me. Nje humbje ne vlere eshte ndryshuar nese ka pasur nje ndryshim ne vleresimin e perdorur per percaktimin e shumes se rekuperueshme. Nje humbje nga renia ne vlere eshte ndryshuar vetem drejte niveli qe shuma e mbartur e aktiveve nuk kapercen shumen e mbartur qe ka qene percaktuar, neto prej zhvleresimit ose amortizimit, nese nuk kishte qene njohur asnje renie ne vlere.

g. Qirate operative

i) OSSH eshte qiramarres

OSSH SH.A, kryesisht hyn në marrëveshje për qira operative. Pagesat totale te kryera sipas kontratës së qirasë operative regjistrohen si shpenzime të periudhës duke u shpërndarë përgjatë jetëgjatësisë së kontratës, duke u bazuar në metodën lineare, dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Kur qiraja operative përfundon përpara afatit të qirasë, çdo pagesë që i bëhet qiradhënësit në formën e penaliteteve për mbylljen e kontratës përpara afatit, regjistrohet si shpenzim në periudhën kur ndodh përfundimi i kontratës.

h. Inventaret dhe prodhimi ne proces

Inventari vlersohet me me te voglen midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme eshte cmimi i parashikuar i shitjes gjate aktivitetit normal te biznesit, minus kostot e vleresuara te perfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Inventari dhe prodhimi në proçes vlerësohen me më të voglën midis kostos (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti) dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.Kostoja e inventarit bazohet sipas metodes hyrje-e pare dalje-e pare (FIFO), dhe perfshine shpenzimet per sigurimin e inventarit, kostot e prodhimit dhe shenderrimit dhe kosto te lindura per sjelljen e tyre ne vendin dhe kushtet ekzistuese. Ne rastet e inventarit te prodhuar dhe te prodhimit ne proces, kostot perfshijne nje shperndarje te vecante te shpenzimeve te prodhimit bazuar ne kapacitetin normal operativ.Kosto e inventarit mund gjithashtu te perfshije transferimin nga kapitali te ndonje fitimi ose humbjes nga blerjet e inventarve ne monedhe te huaj.

i. Detyrimet per pension, perfundimin e punes, te tjera detyrime ndaj punonjesve dhe detyrimet per perfitimet pas largimit nga puna

- *Kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore*

OSSH SH.A. paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat bëjnë të mundur përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë është pëgjegjëse për të përcaktuar vlerën minimale për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore për qëllime të pensionit duke u bazuar në një skemë të pensioneve me kontribut të përcaktuar. Kontributet e OSSH SH.A. në skemën e përfimit të pensionit regjistrohen si shpenzime kur ato përllogariten.

j. Provizionet

Nje provizion njihet, neqoftese si rezultat i nje ngjarje te kaluar, atehere OSSH ka nje obligim ligjor ose kontraktual ne te tashmen qe mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe pritet te shoqerohet me dalje te flukseve monetare per shlyerjen e detyrimit. Provizonet jane percaktuar nga skontimi i flukseve te ardhshme monetare te parashikuara me normen interesi para tatimeve qe reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe faktoret e riskut qe mbartin.

k. Tatimi i shtyre

Tatimet e shtyra llogariten në përputhje me metodën e detyrimeve për të gjitha diferencat e përkohshme që lindin midis bazës së taksueshme të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës së tyre të mbartur. Të gjitha diferencat e lindura nga ndryshimet e normës së tatimit regjistrohen në llogaritë e kapitalit ose në të ardhurën (humbjen) neto në vitin në të cilën ka ndodhur ndryshimi i tatimit. Aktivet për tatimet e shtyra paraqiten në bilancin kontabël atëherë kur ka

siguri se do të realizohen përfitime nga tatimi në të ardhmen. Aktivet dhe detyrimet për tatimet e shtyra nuk skontohen.

Për të vlerësuar mundësinë e OSSH për të rekuperuar aktivet për tatimet e shtyra, merren në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Ekzitenca e detyrimeve për tatimet e shtyra,
- Parashikimi për rezultatet e ardhshme të tatimit,
- Ndikimi i kostove jo periodike të përfshira në të ardhurat ose humbjet në vitet e mëparshme të cilat parashikohen nëse nuk do të përsëriten në të ardhmen,
- Të dhënat historike që lidhen me rezultatet e tatimeve në vitet e mëparshme, dhe
- Nëse kërkohet, strategjia e planifikimit të tatimit, të tilla si plani i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të nënvlerësuar.

l. Tatimi aktual

Norma aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet bazuar në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

m. Te ardhurat

Te ardhurat perfshijne te ardhurat e shitjes dhe sherbimeve neto nga aktiviteti kryesor i biznesit te OSSH SH.A., tatimi mbi vleren e shtuar neto (TVSH). Shumica e shitjeve te OSSH SH.A. jane gjeneruar nga shitja e energjise dhe instalimet nga klientet e rinj.

i) Shitja e energjise elektrike

Te ardhurat nga shitja e energjise elektrike perfshijne vleren e matur te furnizimit me energji elektrike. Faturat per furnizimin me energji elektrike emetohen ne baza mujore.

E ardhura ne pergjithesi eshte matur me vleren e drejte te shumes se arketuar ose per tu arketuar. Kur nje pagese e shtyre ka nje impakt te rendesishem ne perllogaritjen e vleres se drejte, ajo eshte llogaritur duke skontuar pagesat e ardhshme. Vleresimi i aftesise se mbledhjes eshte vendimtare ne percaktimin nese te ardhurat apo shpenzimet do te njihen. Si pjese e procesit te njohjes se te ardhurave, OSSH SH.A. vlereson nese eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te lidhura me transaksionet do te perfitohen nga OSSH SH.A.. Nese OSSH SH.A. eshte e pasigurt qe perfitimet ekonomike do te peftohen prej OSSH SH.A., e ardhura eshte e shtyre dhe njihet ne baza monetare. Megjithate, nese shfaqet pasiguri per mbledhjen e nje shume te perfshire tashme ne te ardhura, shuma njihet si nje shpenzim ne koston e shitjes.

ii) Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi per te gjitha instrumentet financiare interes-sjellese, pervec atyre te klasifikuara si te mbajtura per tregtim ose te percaktuara me vlere tregu nepermjet humbjes ose fitimit, njihen brenda 'te ardhura nga interesi' dhe 'shpenzime nga interesi' ne pasqyren e te ardhurave duke perdorur metoden efektive te interesit.

Metoda efektive e interesit eshte nje metode per llogaritjen e kostos se amortizimit te nje aktivi financiar ose nje detyrimi financiar dhe ne shperndarjen e te ardhures se interesit ose te shpenzimit te interesit mbi periudhen perkatese. Norma efektive e interesit eshte norma qe skonton ekzaktesisht pagesat/arketimet e ardhshme nepermjet jetes se pritshme te instrumentit financiar ose një periudhe me te shkurter per te arritur ne vleren e mbartur neto te aktiveve ose detyrimeve financiare.

Kur llogaritet norma efektive e interesit, OSSH vlereson fluksin e parase duke marre parasysh te gjithe kushtet kontraktuale te instrumentit financiar (per shembull, opsionet parapaguara) por nuk merr parasysh humbjet e ardhshme te kredive dhe paradheniet. Llogaritja përfshin te gjithe tarifat dhe shumat e paguara ose te arketuara

ndermjet paleve te kontrates qe jane nje pjese integrale e normes efektive te interesit, kostos se transaksionit dhe te gjitha shtesat dhe pakesimet e mundshme.

Pasi nje aktiv financiar ose aktive financiare te ngjashme kane patur humbje per shkak te renies ne vlere, te ardhurat nga interesi njihen duke perdorur normen e interesit njihen duke perdorur normen e interesit efektiv te perdorur per testin e vleres. Te ardhurat dhe shpenzimet e interesit te shfaqura ne pasqyren e te ardhurave perfshijne: Interesi qe rrjedh prej aktiveve dhe detyrimeve financiare qe maten me koston e amortizuar mbi bazen e nje norme efektive interesi.

n. Instrumentat financiar dhe c'rregjistrimi i tyre

OSSH mban vetem instrumenta financiar jo-derivativ, perfshire Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme, Mjete Monetare dhe ekuivalente te Mjeteve Monetare, hua dhe huamarrjet, dhe llogari te tjera te pagueshme. Instrumentat financiar jo-derivativ njihen fillimisht me vleren e drejt plus, per instrumentat jo me vlere te drejt nepermje fitimit/humbjes, ndonje kosto direkte ngarkuar transaksionit, pervec si eshte pershkruar me poshte. Njohja ne vijim e Instrumentave financiar jo-derivativ pershkruhet me poshte. Nje instrument financiar njihet nese OSSH behet pale e nje kontrate per instrumenta. Aktivet financiare jane c'rregjistruar nese te drejtat kontraktuale te Kompanise per flukset monetare nga aktivet financiare mbarojne ose nese OSSH transferon aktivin financiare nje pale tjeter pa mbajtur kontrollin ose te gjithe risqet dhe perfitimet e konsiderueshme te aktivit. Blerejet dhe shitjet normale te aktiveve financiare jane regjistruar me daten e tregtimit, p.sh. ne daten qe Kompania angazhohet te blej apo te shes aktivin. Detyrimet fiananciare jane c'rregistruar nese detyrimet e specifikuar ne kontrate te Kompanise mbarojne ose jane shlyer ose anulluar.

i) Aktivet financiare

OSSH SH.A. i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: Huadhëniet dhe të Arkëtueshmet të cilat klasifikohen në Llogaritë e arkëtueshme. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare.

Huat dhe paradheniet

Huatë dhe Paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativ me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk kuotohen në një treg aktiv, përveç rasteve kur: (a) ato që OSSH planifikon ti shesë menjëherë ose në afatshkurtër, të cilat janë të klasifikuara si asete për tregti, dhe ato që OSSH që në momentin e parë i klasifikon si vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes; (b) ato që OSSH i kalsifikon si të disponueshme për shitje; ose (c) ato që çdo mbajtës nuk mund të rikuperojë tërsisht gjithë vlerën e investimit fillestare, përveç rastit të përkeqësimit të indeksit të creditit.

Huatë dhe paradhënie njihen kur OSSH behet pjesë e një marrëveshjeje kontraktuale. Huatë dhe Paradhëniet fillimisht maten me kostot duke përfshirë çdo kosto transaksioni të ndodhur, ndërsa më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga renia ne vlere.

b. Llogarite e Arketueshme

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë para. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen me koston e amortizuar pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Llogaritë e Arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionet për rënie të vlerës.

c. Investimet te mbajtura deri ne Maturim

Investimet te mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturim të fiksuar, për të cilat Drejtimi ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Nëse OSSH do të shiste një pjese të rëndësishme të aktiveve të mbajtura deri në maturim, atëherë e gjithë kategoria do të riklasifikohet si aktive për shitje.

Investimet deri në maturim njihen në datën e vendosjes se transaksionit dhe maten me koston fillestare duke përfshirë të gjitha kostot e transaksioneve për këtë aktiv. Më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga zhvlerësimi. Kosto e amortizuar matet me metodën e normës efektive të interesit. Normat e Interesit dhe vlerat e

skontuara, duke përfshirë kostot fillestare të transaksionit, përfshihen në vlerën e mbartur të instrumentit përkatës dhe amortizohen duke u bazuar në normën efektive të interesit të instrumentit, kur aplikohet.

ii) Detyrimet financiare

OSSH i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: Llogari të pagueshme dhe detyrime financiare per huamarrje.

a. Llogarite e Pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

b. Huamarrja

Huamarrja njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se OSSH SH.A. ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

iii) C'rregjistrimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar sipas përkufizimit të SNK32 "Instrumentat financiare: Shënimet shpjeguese dhe Paraqitja" çrregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur OSSH SH.A. parashikon që nuk do gjenerohen më flukse parash nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Kur kemi te bëjmë me mosarkëtim nga klienti, në rastin e Llogarive të arkëtueshme, dhe kryejmë një transferim të gjithë risqeve dhe shpërblimeve që lidhen me pronësinë, atëhere kjo llogari klasifikohet për një transferim, duke bërë të mundur kështu që kjo Llogari e arkëtueshme të jetë e vlefshme për çrregjistrim, duke supozuar që pagesa me vonesë përbën një risk të parëndësishëm. Një interpretim më i ngushtë i konceptit të "transferim thelbësor i rreziqeve dhe përfitimeve" mund të vendosë në pikëpyetje trajtimin kontabël që është adoptuar.

iv) Renia ne vlere e Aktiveve Financiare

a. Aktivet e mbartura me koston e amortizuar

OSSH vlerëson në çdo datë të bilancit nëse ka evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet dhe humbjet e renies ne vlere ndodhin vetëm nëse ka evidenca objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit (një 'ngjarje humbjeje') dhe që një ngjarje humbjeje (ose disa ngjarje) kanë ndikim mbi flukset monetare të parashikuara të aktivit financiar që mund të vlerësohet me efektivitet. Kriteret qe perdor OSSH per te percaktuar qe ka evidenca objektive per nje humbje nga renia ne vlere perfshijne:

- Shkelje ne pagesat kontraktuale te kryegjese ose interesit;
- Veshtiresi te provuara likuiditeti nga huamarrsi (p.sh. raportet e kapitalit, raporti i fitimshmerise etj);
- Prishje e marrveshjese ose kushteve te huase;
- Fillimi i masave te falimentimit;
- Perkeqesim i pozicionit konkurues te huamarresit;
- Perkeqesim i vleres se kolateralit

Periudha përkatëse mes një humbjeje dhe identifikimit të saj përcaktohet nga drejtimi per secilin nga portofolet e indentifikuar. Në përgjithësi, periudhat e perdorura variojnë nga tre në 12 muaj; në raste të veçante përdoren periudha më të gjata. OSSH vlereson ne fillim ne se ka evidence objektive qe ekziston nje renie ne vlere vecanerisht per nje aktive financiare qe jane te rendesishem, dhe ne menyre te vecante ose kolektive per aktive financiare qe nuk jane individualisht te rendesishem. Nese OSSH percakton qe nuk ekziston evidence objektive per renien ne vlere per nje aktiv financiar te vleresuar individualisht, i rendesishem ose jo, ajo e perfshin aktivin ne nje klase te

aktiveve financiare me karakteristika te ngjashme te riskut te kreditit dhe i vlereson ata kolektivisht per renien ne vlere. Aktivet qe jane vleresuar individualisht per renien ne vlere dhe per te cilet humbja nga renia ne vlere eshte/ose vazhdon te njihet nuk jane perfshire ne vleresimin kolektiv per renien ne vlere.Vlera e provizionit është diferenca mes vlerës së mbartur të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të parashikuara (perjashtuar humbjet e ardhshme te kreditit qe nuk kane ndodhur), të skontuara me normën efektive të interesit.Vlera e mbartur reduktohet përmes një llogarie zbritjeje, dhe vlera e humbjes regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave. Kur ndonje Hua ose investim i mbajtur deri ne maturim ka nje norme interesi te ndryshueshme, normat e skontimit per te matur ndonje humbje nga renia ne vlere eshte norma efektive aktuale e intersit te percaktuar ne kushtet e kontrates.

o. Shperndarja e dividenteve

Shperndarja e dividenteve per Aksioneret e Kompanise eshte njohur si nje detyrim ne pasqyrat financiare te Kompanise ne periudhen ne te cilen dividentet jane aprovuar nga Aksioneret e Kompanise.

p. Grantet Qeveritare

Grantet Qeveritare jane njohur fillimisht si te ardhura te shtyra kur ka nje siguri te arsyeshme qe ato do te arketohen dhe qe OSSH do te plotesoje kushtet e lidhura me grantin. Grantet qe kompesojne OSSH-ne per shpenzimet rrjedhese njihen ne fitim/humbje me baza sistematike ne te njejten periudhe qe jane njohur shpenzimet. Grantet qe kompesojne OSSH-ne per kostot e nje aktivi jane njohur ne Fitim/Humbje mbi baza sistematike mbi jete e dobishme te aktivit.

q. Mjetet Monetare dhe ekuivalentet e Mjeteve Monetare

Në përputhje me SNK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin paranë (arkëtimet në para dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak) Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalnetët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrrenspondojnë me paranë dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3. Menaxhimi i Riskut

Aktivitetet e OSSH SH.A. janë të ekspozuara ndaj një shumëllojshmërie risqesh financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizat, vlerësimin, pranimin dhe manaxhimin e disa shkallëve të riskut ose kombinime të risqeve. Marrja përsipër e riskut nga ana e biznesit, dhe risqet operacionale janë pasoja të paevitueshme e të qënurit biznes. Prandaj, qëllimi i OSSH SH.A. është të arrijë një balancë të përshtashme midis riskut dhe kthimit dhe të minimizojë efektet potenciale të kundërta në performancën financiare të OSSH .

Keshilli Mbikqyres ka pergjegjesi te plote per percaktimin dhe mbikqyrjen e struktures se menaxhimit te riskut te Kompanise. Politikat e menaxhimit te riskut te Kompanise jane krijuar per te identifikuar dhe analizuar riskun nga OSSH, te vendos limitet dhe kontrollet e duhura te riskut, dhe te monitoroje riskun dhe ruajtjen e limiteve te vendosura.

Llojet më të rëndësishme të risqeve të Kompanisë janë risku i kreditimit, risku i likuiditetit, risku i tregut dhe risqet e tjera operacionale. Risku i tregut përfshin riskun e monedhës, riskun e normës së interesit dhe riskun e cmimeve te tjera.

i) Risku i tregut

OSSH SH.A. është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, i cili është risku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme të Mjeteve Monetare të një instrumenti financiar do të jenë të luhatshme për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut.

Risqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në normat e interesit, produktet e monedhës dhe të kapitalit, ku të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut dhe ndryshimeve në nivelin e paqëndrueshmërisë të normave të tregut ose çmimeve të tilla si normat e interesit, spredi i kreditimit, normat e kursit të këmbimit dhe çmimi i kapitalit. Ekspozimi i OSSH SH.A. ndaj riskut të tregut lind nga portofolet e patregëtueshme. Portofolet e patregëtueshme përbëhen nga risqe të kursit të këmbimit që lindin nga llogaritë e arkëtueshme të OSSH SH.A. dhe Huamarrja.

- *Risku i kurseve te kembimit*

OSSH SH.A. ekspozohet ndaj efekteve të luhatjeve të normave ekzistuese të kursit të këmbimit në pozicionin e saj financiar dhe flukset e Mjeteve Monetare. Risqet e kursit të këmbimit lindin kur transaksionet e ardhshme tregëtare ose aktivet ose detyrimet e njohura janë të shprehura në një monedhë e cila nuk është monedha funksionale e OSSH SH.A. LEK.

